SE-IZLAZNA-OUTGOING
REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS VLADA KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVA
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 0204-254/3
Data Datum Date 04.03.2014

# Republika e Kosovës

## Republika Kosova-Republic of Kosovo

## Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

Datë:27.02.2014
Nr.0204-254

**PËR:** **Imri Ahmeti,** Kryetar i Komunës së Lipjanit
**Vlora Limani-Hajnuni,** Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Lipjanit

**LËNDA: KËRKESË PËR RISHQYRTIMIN E VENDIMIT TË KOMUNËS SË LIPJANIT Nr. 112-3408/2014 të pranuar më datën 27.02.2014**

Të nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, duke u bazuar në kompetencat dhe përgjegjësitë e përcaktuara në nenin 81.4 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, si dhe Rregulloren Nr. 02/2011, për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive shtojca XII, pas shqyrtimit të vendimit Nr.112-3408 /2014 të miratuar me datën 29.01.2014 nga Kuvendi i Komunës së Lipjanit, konstaton se:

- Vendimi Nr.112-3408 /2014 për emërimin e z.Sefer Tasholli, nënkryetar të Komunës për Komunitete është i kundërligjshëm.
- Ky Vendim, është në kundërshtim me nenin 61.1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale si dhe Udhëzimin Administrativ Nr. 2014/01 MAPL neni 4, paragrafi 4.3 në të cilin është e përcaktuar se"***Nënkryetari i komunës për komunitete nga radhët e komuniteteve jo shumicë*** propozohet nga kryetari i komunës dhe emërohet me vendim të kuvendit të komunës, nga shumica e anëtarëve që janë të pranishëm dhe votojnë, si dhe shumica e anëtarëve të kuvendit që janë të pranishëm dhe votojnë, të cilët i përkasin komuniteteve jo shumicë."

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, duke u bazuar në nenin 81 pika 4 e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, kërkon nga Kuvendi i Komunës së Lipjanit që të ndërmarrin veprime konkrete që në afat prej 30 ditësh të bëjë rishqyrtimin e këtij vendimi.

Me respekt,

**Slobodan Petrović,**
**Zëvendëskryeministër dhe Ministër i MAPL-së**

**Kopje:** *Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL*
*Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së*
*Arkivit të MAPL-së*

DALËSE-IZLAZNA-OUTGOING
REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS VLADA KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVA
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 0204-254/3
Data Datum Date 04.03.2014

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
**Qeveria - Vlada - Government**
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

Datum:27.02.2014
br.0204-254

**Za:** **Imri Ahmeti,** Gradonačelnik opštine Lipjane
**Vlora Limani-Hajnuni,** Predsedavajući Skupštine opštine Lipjane

**Predmet : Zahtev o ponovnom razmatranju odluke opštine Lipjane br. 112-3408/2014 primljeno dana 27.02.2014**

Poštovani/e,

Ministarstvo administracije lokalne samouprave na osnovu nadležnosti i odgovornosti definisano članom 81.4 zakona o lokalnoj samoupravi , i uredbe br. 02/2011, o odgovornim administrativnim oblastima kancelarije premijera i Ministarstva dodatak XII, nakon razmatranja odluke br.112-3408 /2014 odobreno dana 29.01.2014 od strane Skupštine opštine Lipjane,konstatuje da :

- Odluka br.112-3408 /2014 o imenovanju g.Sefer Tasholli, kao podpredsednika opštine za zajednice je protiv zakonito.
- Ova odluka je u suprotnosti sa članom 61.1 zakoja o lokalnoj samoupravi kao i administrativnim uputstvom br. 2014/01 MALS član 4, paragraf 4.3 gde je ddefinisano da "***Podpredsednik opštine za zajednice iz redova ne većinske zajednice*** predlaže se od strane gradonačelnika opštine i imenuje se odlukom Skupštine opštine , većinom članova koji su prisutni i glasaju kao i većinom članova Skupštine koji su prisutni i glasaju ,i pripadaju ne većinskoj zajednici ."

Ministarstvo administracije lokalne samouprave , na osnovu člana 81 tačka 4 zakona o lokalnoj samoupravi , traži od strane Skupštine opštine Lipjane da preduzme konkretne mere da u roku od 30 dana ponovo izvrši razmatranje ove odluke.

, Sa poštovanjem,

**Slobodan Petrović,**
**Zamenik premijera i Ministar MALS-a**

**Kopija:** *Besnik Osmani, Generalni sekretar MALS-a*
*Rukovodiocim aodeljenja MALS-a*
*Arhivi MALS-a*

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në bazë të nenit 58 pika "e" dhe nenit 61, 61.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale "Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës " nr. 28. të dates 04. qershor 2008 dhe nenit 44 pika "e" të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të dates 26. 09. 2008, Kuvendi i Komunës së Lipjanit në mbledhjen e mbajtur me 29. 01. 2014, pas shqyrtimit të propozimit të Kryetarit të Komunës merr këtë:

# V E N D I M
## PËR EMËRIMIN E NËNKRYETARIT TË KOMUNËS PËR KOMUNITETE

I. **Sefer Tasholli**, nga Gadimja e Ulët , me profesion Inxhinier i diplomuar emërohet Nënkryetar i Komunës për Komunitete të Komunës së Lipjanit.

II. Nënkryetari i emëruar sipas pikës 1 të këtij Vendimi është i emëruar politik.

III. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë.

IV. Me kopje të Vendimit të njoftohet i emëruari, Zyra e Përsonelit, MAPL, ndërsa një kopje të ruhet në regjistratorin e materialeve të Kuvendit.

**15 Nr. 112-3408**
**Lipjan, me 29. 01. 2014**

**KUVENDI KOMUNAL LIPJAN**

**Kryesuesja**
**Vlora Limani-Hajnuni**